



ORGANIZUAR NGA:



Sherqta Kulturore "Syri Blu"
Rr. Dëshmorët 58 406
E-mail: syriblu2001@yahoo.com




Shqiptarët e Muzikës", Rr. Dëshmorët 58 406
Fax: 04 372198 / 04 069 40 37 866
E-mail: shqiptarzetemuzikes@hotmail.com

SEZONI KONCERTOR NDERKOMBETAR I MUZIKES
WWW.KLASIKALBANIA.COM

EDICIONI I 9^{-të}

2008-2009



SOCIETE GENERALE GROUP
Së bashku për të ardhmen

PROGRAMI

PJESA E PARE:

SOUVENIR D'UN LIEU CHER - P.I.TCHAIKOVSKY (1840-1893)

- 1.MEDITATION
- 2.SCHERZO
- 3.MELODY

SONATA per VIOLIN dhe PIANO - F.POULENC(1899-1963)

- 1.ALLEGRO CON FUOCO
- 2.INTERMEZZO
- 3.PRESTO TRAGICO

PJESA E DYTE:

LE GRAND TANGO - A.PIAZZOLLA(1921-1992)

I rregulluar nga SOFIA GUBAIDULINA

FANTAISIE BRILLANTE - JENÖ HUBAY(1858-1937)

DUO

SILVANA SKENDERI - PIANO
(SHQIPERI)

REZART KAPETANI - VIOLIN
(SPANJE)

Ne program vepra te autoreve:

Tchaikovsky ,Poulenc

Piazzolla-Sofia Gubai Dulina,Jenö Hubay

E shtunë 11.04.2009, ora 19
Akademia e Arteve

Curriculum

SILVANA SKENDERI

Pas mbarimit të studimeve për Piano me rezultate maksimale në Liceun Artistik "Jordan Misja", vijoi e perfundoi studimet e larta po me rezultate të tilla, në Akademinë e Arteve në Tiranë.

Pas perfundimit të studimeve të larta, për disa vite ka punuar në Teatrin Kombëtar të Operas e Baletit, me titullin Koncert-Maester. Gjatë kësaj periudhe përballë me një veprimtari artistike intensive si Koncert-maester dhe si pianiste e Orkestres së TOB-it, duke realizuar një repertor të gjere veprash operistike, në bashkpunim të vazhdueshëm me shumë dirigjente, vecanerisht të huaj.

Në repertorin e larmishëm të veprimtarive artistike të kësaj periudhe bëjnë pjesë mjaft koncerte recitale si Pianiste- Soliste, si Koncert -Maester në koncerte recitale të Kengetareve Soliste të TOB, dhe e Koncerteve Recitale të Korit të TOB-it.

Për disa vite radhazi është pianiste e Korit Femëror të Akademisë së Arteve nën drejtimin e të mirnjohurit Dirgj Prof. Milto Vako, nderuar me disa Cmime Nderkombëtare dhe një CD hedhur në treg së fundmi.

Për vite me radhe është pianiste e Orkestres "Madre Tereza", pianiste e koncertit të përvitshëm "3 Tenoret", e Festivalit Operistik "Jorgjia Truja", e Festivalit Operistik Nderkombëtar "Marie kraja".

Gjithashtu është Pianiste Zyrtare e "Garat Internacionale të Kosovës" (2005-2006-2007), Konkursit Violinistik Nderkombëtar "Islam Petrela" (2005-2006), Pianiste Zyrtare e "Tirana Music Festival" (2006-2007), e Festivalit "Mozaik 2008" në klasën e Prof. vienez Kovacic

Që prej tre vitesh bashkëpunon dhe si pianiste e Orkestres Simfonike të RTSH.

Veprimtaria e saj artistike pasurohet edhe me një sërë koncertesh të Muzikës së Dhomes në qytete të ndryshme të vendit dhe të huaja.

Nga viti 2003 është Pedagoge në Akademinë e Arteve, në Departamentin e Interpretimit.

Veprimtaria e gjere artistike e viteve të fundit është pasuruar me një sërë koncertesh të Muzikës së Dhomes, brenda dhe jashtë vendit, kryesisht me Koncerte DUO Piano & Violinë në bashkpunim me artiste të dryshëm të vendit e të huaj si me violinisten Franceze Louiss Chissou (2008), me spalen e Orkestres së Operas Suela Piciri (Rumani -Prill 2007, Tirane Dhjetor 2007), Angela Baek (Itali 2006) Etj.

Për here të pare realizon një Koncert Bamiresie në Zagreb (Kroaci 2007 - në mbështetje të semureve të kancerit). Aktivitet që u mbështet se tepërmi nga shtypi dhe kritika Kroate.

Në prill 2007 I akordohet nga Pro-Helvetia një bursë Specializimi në Rumani, duke sjelle për here të pare në skenën Shqiptare, krijimtarinë e kompozitorit të famshëm rumun George Enescu.

Në vitin akademik 2007 - 2008 I akordohet një bursë Specializimi nga Instituti Italian i Kulturës në Konservatorin "G. Rossini" për Muzikën e Dhomes. Specializime që perfunduan me koncerte dhe vleresime maksimale nga Bordi i Profesoreve të shkollave perkatëse.

Ky është Bashkpunimi i pare me violinistin Rezart Kapetani dhe koncerti i dytë në Sezonin e përvitshëm nderkombëtar "Klasik".

Një pjesë e programit të këtij koncerti, si : Sonata për Violinë & Piano e Francis Poulenc, dhe Le Grand Tango e kompozitorit Astor Piazzolla, interpretohen për here të pare për publikun Shqiptar.

REZART KAPETANI

"...Rezart Kapetani është violinist me nivel, me teknokë të shkelqyer e të sigurt, me tingëllim të plote, muzikalitet e temperament, si dhe shpreh preokupacion të lartë në interpretim..."

Studimet për violinë i filloi me Adem Beqirin për të vazhduar me pas Liceun Artistik "Jordan Misja", me Prof. Zishan Kumbaro dhe me pas kreu vitin e pare të Akademisë së Arteve me Prof. Roland Xhoxhi.

Në moshën 11 vjeçare fitoi Cmimin e Pare në Konkursin Kombëtar të të Rinjve në Tiranë. Në moshën 15 vjeçare deputon në Orkestren e të Rinjve të Tiranës. Në 1994, në një konkurim të zhvilluar në Tiranë, përzgjidhet dhe merr pjesë në Orkestren e të Rinjve të Mesdheut, e cila ndermori një turne një mujor në Francë, Tunizi, Itali. Në këte formacion ai studioi e interpretoi nën drejtimin e Prof. Kemal Akcag dhe Prof. Michel Tabachnik

Po atë vit zhvendoset në MURCIA të Spanjës, ku vijoi e perfundoi studimet në Konservatorin Superior të këtij qyteti, me Prof. Joaquim Palomares. Aty u diplomua me HONORY PRIZE dhe fitoi cmimin e Grades Superior.

Në 1995 fiton Cmimin e Pare në Festivalin Nderkombëtar të Violinistëve të Rinj në Murcia, dhe një vit më vonë fiton Cmimin e Dyte në Konkursin Nderkombëtar të Violinistëve të Rinj në Granada. Në 1999 shpallet finalist në Konkursin Nderkombëtar të Barcelonës. Një vit më pas fiton shtetësinë Spanjolle.

Repertori i tij përmban regjistrime në CD të koncerteve të Bach-ut në La- e Mi- për dy

violinë, Sonata Nr.1 të Saint Saens, Beethoven Nr.3 dh Rahmaninov. Kohët e fundit ka realizuar një regjistrim të ri me Violinë & Kitare.

Që prej vitit 2000 e në vazhdim zhvillon një veprimtari të gjere koncertore si Solist, duke deputuar në formacione të tilla si: Orkestra Baroke Valenciane, Orkestra Simfonike e Murcias, Orkestren Simfonike të të Rinjve të këtij qyteti, dhe Orkestren Simfonike të RTSH-Tiranë, si dhe ka dhënë mjaft koncerte me Orkestren "AMICITA".

Është anetar themelues i Kuartetit "THADER" dhe anetar bordi i pedagogëve në Orkestren e të rinjve të Murcias, ku ka drejtuar instrumentiste të moshave të reja. Prej këter vitesh ka qenë anetar i katedrës së violines në Konservatorin Superior të Murcias. Aktualisht është pedagog në Konservatorin Profesional në LORKA.

Ka një repertor të pasur koncertor si solist jo vetëm në Spanjë por edhe në vende të tjera si në Itali, Francë, Austri, Shqipëri etj. Në mars 2008 ndermori një tur 2 javor në Rusi, duke dhënë disa koncerte me Violinë & Piano, si dhe me Orkestren e Filarmonisë Shtetërore të Tomskut.

Në maj 2005 dha koncertin e tij të pare në Tiranë me Orkestren e Tiranës. Një vit më pas dha koncertin e dytë, i shoqëruar nga një pianiste spanjolle dhe në qershor 2007 dha koncertin e 3 me Orkestren Simfonike Shqiptare të RTSH. Ky është koncerti i tij i këter në Tiranë.

Shtypi dhe kritika spanjolle e vleresojnë si Violinist virtuoz, me vlera interpretative, profesionale dhe artistike.